





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj  
Opština Skenderaj  
Municipality of Skenderaj

### Njoftim për dëgjimin buxhetor publik me qytetarë për KAB 2027-2029

Duke u bazuar në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Statutin e Komunës së Skenderajt dhe Udhëzimit Administrativ të MAPL-së për Administratë të Hapur në Komuna, kryetari i Komunës së Skenderajt, Sami Lushtaku dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në bashkëpunim me Zyrën për Informim, publikojnë njoftimin për organizimin e dëgjimit publik me qytetarë për përgatitjen e KAB (Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027-2029).

Njoftohen të gjithë qytetarët e Komunës së Skenderajt, përfaqësuesit e lagjeve dhe fshatrave, OJQ-të, shoqatat e grave, shoqëria civile, bizneset, fermerët, të rinjtë e studentët, përfaqësues të institucioneve të ndryshme e Komunës së Skenderajt dhe të gjithë të interesuarit, se më datën 03.06.2026 do të mbahet dëgjimi buxhetor për të pranuar komentet, sugjerimet, propozimet dhe kërkesat lidhur me hartimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027-2029.

KAB-i është dokument i rëndësishëm për planifikimin e buxhetit dhe hartimin e listës së investimeve kapitale kurse përmes dëgjimeve buxhetore qytetarët bëhen pjesë e vendimmarrjes. Ky dëgjim do të mbahet me datë 3 Qershor 2026 sipas kalendarit të mëposhtëm. Në këtë dëgjime buxhetore mund të marrin pjesë: qytetarët, përfaqësuesit e fshatrave, OJQ-të, komunitetet e ndryshme, gratë, pensionistët, të rinjtë dhe studentët, bizneset, përfaqësues nga institucione të ndryshme dhe qytetarë të tjerë pa dallim.

Dëgjimi buxhetor	Dita/data e mbajtjes	Vendi	Ora
Dëgjimi buxhetor me përfaqësuesit e lagjeve dhe fshatrave, OJQ-të, shoqatat e grave, shoqërinë civile, bizneset, fermerët, të rinjtë e studentët e Komunës së Skenderajt dhe të gjithë të interesuarit e tjerë.	E mërkurë, 03 Qershor 2026	Salla e Kuvendit komunal, KATI IV	13:30

Për më shumë detaje, për Qarkoren buxhetore përmes të cilës hartohet Kornizën Afatmesme Buxhetore për Komunën e Skenderajt mund të vizitoni vegëzat e mëposhtme:

Faqen zyrtare të komunës në internet në rubrikën e konsultimeve publike:

<https://skenderaj.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/05/987-MF-DB-Qarkorja-Buxhetore-2027-01.pdf>

Platforma qendrore e konsultimeve publike:

<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42825>

Komentet dhe sugjerimet mund t'i dërgoni në emailat: [behxhet.maliqi@rks-gov.net](mailto:behxhet.maliqi@rks-gov.net), [besiana.thaci@rks-gov.net](mailto:besiana.thaci@rks-gov.net) dhe [komuna.skenderaj@rks-gov.net](mailto:komuna.skenderaj@rks-gov.net).



Besjana Thaçi

Zyra për Informim